Paneli këshilldhënës për të drejtat e njeriut

Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

VENDIM

Data e miratimit: 9 shtator 2010

Lënda nr. 02/09

S. C.

kundër

UNMIK-ut

Paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut, në seancën e mbajtur më 9 shtator 2010, me pjesëmarrjen e anëtarëve vijues:

z Marek NOWICKI, kryesues
z Paul LEMMENS
znj Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga
z Rajesh TALWAR, zyrtar ekzekutiv

Pasi shqyrtuan ankesën e lartpërmendur, të parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, të datës 23 mars 2006,

Pasi diskutuan, vendosen si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është parashtruar më 15 janar 2009 dhe është regjistruar në të njëjtën datë.

2. Më 20 prill 2009, Paneli kërkoi informata të tjera nga ankuesja. Ankuesja u përgjigj më 18 maj 2009.

3. Më 9 qershor 2009, Paneli ia komunikoi lëndën PSSP-së me qëllim të dhënies së komenteve të UNMIK-ut lidhur me pranueshmërinë e lëndës.

4. Më 25 gusht 2009, UNMIK-u dha përgjigjen e tij.

5. Më 2 shtator 2009, Paneli ia dërgoi ankueses përgjigjen e UNMIK-ut me qëllim të dhënies së komenteve. Ankuesja iu përgjigj Panelit më 15 shtator 2009.

II. FAKTET

6. Ankuesja, znj S.C., ka qenë bashkëshortja e z. Ah.C. dhe nëna e z. An.C.

7. Në bazë të ankueses, më datën 18 korrik 1999 zotërinjtë Ah.C. dhe An.C. ishin në vendin e tyre të punës në Prizren, së bashku me një anëtar tjetër të familjes. Tre pjesëtarë të uniformuar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) erdhën dhe iu thanë atyre se komandanti i UÇK-së kishte urdhëruar kryerjen e disa punëve. Rreth orës 11:30, zotërinjtë Ah.C. dhe An.C. morën veglat dhe shkuan me veturën e tyre pas xhipit të UÇK-së në drejtim të Gjakovës. Anëtari tjetër i familjes mbeti në shitore, ku pjesëtarët e UÇK-së i thanë se zotërinjtë Ah.C. and An.C. do të kthehen brenda gjysmë ore.

8. Kur zotërinjtë Ah.C. dhe An.C. nuk u kthyen deri në kohën kur shitorja duhej të mbyllej, anëtari i mbetur i familjes u kthye në shtëpi dhe e informoi ankuesen se çka kishte ndodhur. Kur zotërinjtë Ah.C. dhe An.C. nuk u kthyen mëngjesin tjetër, ankuesja dhe anëtari tjetër i familjes shkuan në shtabin e UÇK-së dhe në UNMIK për t'i kërkuar ata, por nuk i gjetën.

9. Pas kësaj, ankuesja ia raportojë zhdukjet UNMIK-ut, KFOR-it dhe Kryqit të Kuq. Ankuesja thotë se policia dhe UÇK-ja kanë marrë deklarata për rastin, por se ajo nuk është në dijeni për çfarëdo hetimi zyrtar.

10. Mbetjet mortore të zotërinjve Ah.C. dhe An.C. janë gjetur në Prizren më 10 gusht 2000. Autopsitë treguan se shkaku i vdekjes së z. Ah.C. dhe z. An.C. ishin plagët e shumta me armë të zjarrit. Deri më 17 shkurt 2003, mbetjet mortore janë identifikuar që i përkasin zotërinjve Ah.C. dhe An.C. Ato i janë dorëzuar ankueses më 6 mars 2003.

11. Pohohet se ankuesja ka dalë jashtë Kosovës në vitin 2003 ose 2004 për shkak të kërcënimeve kundër saj dhe familjes së saj.

12. Në bazë të informatave të dhëna nga PSSP-ja, hetimi mjeko-ligjor për këtë rast është bërë nga hetuesit e Tribunalit Penal Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (TPNJ) në Hagë. PSSP-ja deklaron se, përveç një sasie të vogël të të dhënave mjeko-ligjore që TPNJ-ja ia ka dhënë Njësisë për persona të zhdukur të Policisë së UNMIK-ut, asnjë informatë tjetër nuk i është dhënë Policisë së UNMIK-ut. Paneli thekson se nuk ka ndonjë indikacion për ndonjë bashkëpunim tjetër lidhur me këtë rast mes UNMIK-ut dhe TPNJ-së.

13. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me policinë dhe drejtësinë në Kosovë përfundoi pas marrjes së kontrollit të plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit nga ana e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), pas deklaratës së bërë nga kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), përmes së cilës mirëpritet angazhimi i vazhdueshëm i Bashkimit Evropian në Kosovë. Mes datës 9 dhjetor 2008 dhe 30 mars 2009, të gjitha lëndët penale që mbaheshin në Departamentin e drejtësisë të UNMIK-ut dhe në Policinë e UNMIK-ut i janë dorëzuar homologëve të tyre në EULEX.

III. ANKESAT

14. Ankuesja ankohet për dështimin e pohuar të UNMIK-ut për të hetuar në mënyrë të duhur kidnapimin dhe vrasjen e bashkëshortit dhe djalit të saj. Ajo gjithashtu ankohet se kjo situatë i ka shkaktuar dhimbje dhe vuajtje mendore.

15. Paneli konsideron se ankuesja mund të jetë thirrur në shkeljen e të drejtës për jetë të së shoqit dhe djalit të saj, e cila garantohet me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (KEDNj), si dhe në shkeljen e së drejtës së saj për të mos u trajtuar në mënyrë çnjerëzore dhe degraduese, e cila garantohet me nenin 3 të KEDNj-së.

IV. LIGJI

16. Para shqyrtimit të lëndës për bazueshmërinë e saj, Paneli fillimisht duhet të vendosë nëse duhet të pranojë lëndën apo jo, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë, të parapara në nenet 1, 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

17. Neni 3.3 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 parasheh që Paneli mund të trajtojë çështjen vetëm pasi të përcakton se në shikim të parë nuk është e pabazuar.

18. Ankuesja pohon se kanë ndodhur shkelje thelbësore përkitazi me moshetimin e duhur penal lidhur me kidnapimin dhe vrasjen e bashkëshortit dhe djalit të saj, si dhe me mënyrën se si të afërmit e saj janë trajtuar nga pushteti. Paneli vëren se zotërinjtë Ah.C. dhe An.C. janë parë për herë të fundit më 18 korrik 1999, pra, më shumë se 10 vjet më parë.

19. PSSP-ja argumenton se lënda është e papranueshme *prima facie*. Ai thekson se TPNJ-ja ka pasur mandatin për hetimin e të gjitha krimeve që mund të ndërlidhen me pohime për krime të luftës në kontekstin e luftës së asaj kohe në Kosovë. Duke u bazuar në këtë, dhe pasi që TPNJ-ja ia ka treguar Njësisë për persona të zhdukur të Policisë së UNMIK-ut vetëm raportin e autopsisë dhe të dhënat e tjera mjeko-ligjore, ai mendon se nuk ka pasur bazë, sipas së cilës Policia e UNMIK-ut do ta fillonte procedurën hetimore.

20. Paneli thekson se Statuti i TPNJ-së shprehimisht thotë se juridiksionet shtetërore kanë juridiksion bashkëveprues me TPNJ-në lidhur me krimet e rënda të bëra në Kosovë, përveç nëse dërgohet kërkesa zyrtare gjykatave përkatëse shtetërore për t'ua dhënë kompetencën e tyre në mënyrë të veçantë. Neni 9 i Statutit të TPNJ-së, të miratuar më 25 maj 1993 përmes Rezolutës 827 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara parasheh që:

    (1) Tribunali Ndërkombëtar dhe gjykatat shtetërore kanë juridiksion bashkëveprues për ndjekjen penale të personave përkitazi me shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare, të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë që nga 1 janari i vitit 1991.
    (2) Tribunali Ndërkombëtar ka juridiksion parësor në krahasim me gjykatat vendore. Në cilëndo fazë të procedurës, Tribunali Ndërkombëtar mund t'u bëjë kërkesë zyrtare gjykatave vendore për bartjen e kompetencës së tyre tek Tribunali Ndërkombëtar në përputhje me Statutin aktual dhe me Rregulloren e punës dhe të dëshmive të Tribunalit Ndërkombëtar.

21. Rregullat 9 dhe 10 të Rregullores së punës dhe të dëshmive të TPNJ-së (Rregullorja e TPNJ-së), të miratuara në pajtim me nenin 15 të Statutit të Tribunalit, të cilat hyn në fuqi më 14 maj 1994, parashohin që:

    Rregulla 9: Kërkesa e prokurorit për bartjen e kompetencës

Në rastet kur prokurori mendon se në cilado hetime apo procedura penale të tilla, të zhvilluara në gjykatat e cilitdo shtet:

(i) vepra që hetohet apo që i është nënshtruar procedurave të tilla karakterizohet si krim ordiner;
(ii) ka mungesë të paanësisë, të pavarësisë apo të procedurave që janë të parapara ta mbrojnë të akuzuarin nga përgjegjësia ndërkombëtare penale ose nëse lënda nuk është ndjekur penalisht në mënyrë të syçelë apo
(iii) çështja në fjalë është ngushtë e lidhur a përfshinë në mënyrë tjetër aspekte domethënëse faktike apo juridike që mund të kenë ndërlidhje me hetimet ose ndjekjet penale para Tribunalit,

prokurori mund t'ia propozojë kolegjit të gjyqtarëve, të përcaktuar nga kryetari, që të bëhet kërkesa formale që ajo gjykatë t'ia bartë kompetencën Tribunalit.

Rregulla 10: Kërkesa zyrtare për bartje të kompetencës
(A) Nëse mendon gjykata që ka marrë propozimin për bartje të kompetencës, në bazë të cilado kushteve të cekura në rregullën 9, se kjo bartje është e duhur, gjykata mund të lëshojë një kërkesë formale shtetit në fjalë që gjykata e tij t'ia bart kompetencën Tribunalit.

(B) Kërkesa për bartje të kompetencës përfshinë kërkesën që rezultatet e hetimit dhe kopja e regjistrave gjyqësorë së bashku me aktgjykimin, nëse është bërë, t'i përcillen Tribunalit.

(C) Në rastet kur bartja e kompetencës te Tribunali është kërkuar nga gjykata, çfarëdo gjykimi pasues mbahet në një gjykatë tjetër.

22. Po kështu, Paneli vëren se Zyra e Prokurorit (ZP) e TPNJ-së shprehimisht ka deklaruar se pas themelimit të UNMIK-ut një situatë e tillë gjithashtu vlen për Kosovën:

Vazhdimi i bashkëpunimit me TPNJ-në është i rëndësishëm sepse Këshilli i Sigurimit ka paraparë juridiksion bashkëveprues, të zbatuar nga Tribunali Ndërkombëtar dhe gjykatat vendore me qëllim të ndjekjes penale të personave në kuadër të fushëveprimit të Statutit të TPNJ-së. Rrjedhimisht, autoritetet gjyqësore në Kosovë kanë kompetencë për të gjykuar të akuzuarit për krime të llojit që hyjnë brenda juridiksionit të Tribunalit Ndërkombëtar. Në lëndët e duhura, të cilat duhet të përcaktohen prej lëndës në lëndë, Tribunali Ndërkombëtar ka mundësinë e hapur për të kërkuar gjykatat vendore që t'ia bartin kompetencën e tyre në përputhje me statutin e Tribunalit dhe me Rregulloren e tij të punës dhe të dëshmive (Rregullorja). (Deklarata e Karlla dell Pontes, prokurore e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë lidhur me hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të kryera në Kosovë, Pr/P.I.S./437-E e datës 29 shtator 1999, § 7).

23. Paneli thekson se hetimi i një rasti penal është "fazë e procedurës" në bazë të nenit 9 të Statutit të TPNJ-së, si dhe në bazë të Rregullës 9 dhe 10 të Rregullores së TPNJ-së. Megjithatë, komentet e dhëna nga UNMIK-u nuk japin ndonjë indikacion se TPNJ-ja ka kërkuar zyrtarisht që UNMIK-u t'ia bart kompetencën TPNJ-së lidhur me këtë hetim sipas nenit 9(2) të Statutit të TPNJ-së dhe Rregullave 9 e 10 të Rregullores së TPNJ-së.

24. Rrjedhimisht, Paneli refuzon argumentin e UNMIK-ut, ku thuhet se nuk ka pasur bazë, sipas së cilës UNMIK-u do të fillonte hetimet për zhdukjen dhe vrasjen e zotërinjve Ah.C. dhe An.C. Edhe pse qartazi tregohet se TPNJ-ja nuk ka dhënë informata autoriteteve të UNMIK-ut, përveç disa informatave të kufizuara mjeko-ligjore, një situatë e tillë nuk ka liruar UNMIK-un nga obligimi i tij sipas nenit 2 të KEDNj-së.

25. Paneli po kështu konsideron se ankesat e parashtruara sipas neneve 2 dhe 3 të KEDNj-së ngrisin çështje serioze të fakteve dhe të ligjit, përcaktimi i të cilave do të mund të varej në vlerësimin e bazueshmërisë. Rrjedhimisht, Paneli konkludon se kjo ankesë në shikim të parë nuk është e pabazuar sipas asaj që parashihet në nenin 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

26. Nuk është përcaktuar asnjë bazë tjetër për shpalljen e ankesës si të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri,

SHPALL ANKESËN SI TË PRANUESHME.

Rajesh TALWAR
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryesues